

VENDIM
Nr. 5, datë 23.2.2026

PËR KORRIGJIMIN E DISA GABIMEVE MATERIALE NË RREGULLOREN
“PËR BASHKËPUNIMIN DHE SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT
NDËRINSTITUCIONAL BRENDA DHE JASHTË VENDIT”, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 55, DATË 26.11.2025, TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, të ndryshuar, si dhe të rregullores, “Për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit”, miratuar me vendimin nr. 55, datë 26.11.2025, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Bordi i Mbikëqyrjes Publike në mbledhjen e tij, sipas rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Të miratojë korrigjimet e gabimeve materiale të propozuara për rregulloren “Për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit”, miratuar me vendimin nr. 55, datë 26.11.2025, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 3, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Hiqet numërtimi i paragrafit, pasi neni përmban vetëm një paragraf.
 2. Në nenin 4, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 1, renditja e shkronjave “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g” zëvendësohet me “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”.
 3. Në nenin 7, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 1, renditja e shkronjave “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” zëvendësohet me “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”.
 4. Në nenin 10, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 1, renditja e shkronjave “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” zëvendësohet me “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”.
 5. Në nenin 11, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 2, renditja e shkronjave “a”, “b”, “c”, “d” zëvendësohet me “a”, “b”, “c”, “ç”.
 6. Në nenin 13, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 2, renditja e shkronjave “a”, “b”, “c”, “d” zëvendësohet me “a”, “b”, “c”, “ç”.
2. Të ngarkojë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, strukturën mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike për reflektimin e korrigjimeve materiale në tekstin e rregullores dhe botimin e saj në formën e korrigjuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Dritan Fino

Anëtarë: Adriana Berberi, Luan Abazi, Gjergji Duro, Martin Mici

RREGULLORE
PËR BASHKËPUNIMIN DHE SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT
NDËRINSTITUCIONAL BRENDA DHE JASHTË VENDIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet, procedurat, format dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe autoriteteve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, në zbatim të ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse të parashikuara në kuadrin ligjor për auditimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në bazë të Nenit 5, pika 1, shkronja “I”, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miraturar” i ndryshuar (Ligji për auditimin).

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha subjektet dhe palët e përfshira në veprimtarinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me BMP-në.

KREU II
PARIME BAZË

Neni 4
Parimet themelore

1. Bashkëpunimi i palëve në kuadër të përmbushjes së qëllimit të kësaj rregulloreje udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

a) Parimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë me legjislacionin vendas dhe/ose legjislacionin e vendit tjetër të huaj;

b) Parimi i transparencës – Çdo veprim i bashkëpunimit kryhet në mënyrë të dokumentuar;

c) Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave – Të gjitha informacionet e shkëmbyera do të mbrohen dhe ruhen sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitave të posaçme për informacionin konfidencial të parashikuar në legjislacionin përkatës të palëve në marrëveshje;

ç) Reciprociteti – Në bashkëpunimet ndërkombëtare, BMP-ja vepron sipas parimit të reciprocitetit dhe bazuar në marrëveshje të bashkëpunimit të ndërsjellë;

d) Pavarësia operationale – BMP-ja garanton pavarësinë e saj funksionale në çdo formë bashkëpunimi, në përputhje me kuadrin ligjor për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

dh) Përdorimin e teknologjisë së sigurt për transferimin e informacionit;

e) Ndarja proaktive e informacionit – BMP-ja synon një shkëmbim të vazhdueshëm dhe të strukturuar me të gjitha institucionet publike brenda vendit dhe jashtë vendit, autoritetet mbikëqyrëse vendase dhe të huaja, jo vetëm në bazë kërkesë, por edhe në mënyrë proaktive kur çështjet kanë ndikim të ndërsjellë.

Neni 5

Njohja reciproke e marrëveshjeve rregullatore të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera

1. Marrëveshjet reciproke rregullatore bazohen në parimin e mbikëqyrjes nga autoriteti rregullator i Republikës së Shqipërisë dhe i shteteve të tjera ku audituesi ligjor ose shoqëria audituese është e regjistruar dhe ku njësia ekonomike e audituar ka selinë kryesore të veprimtarisë.

Pa cenuar paragrafin e parë, audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese të regjistruara në regjistrin publik në Shqipëri ose në një shtet tjetër për të kryer shërbime të auditimit ligjor dhe që janë të regjistruar për të kryer shërbime auditimi në një shtet tjetër, i nënshtrohen kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP-ja për auditime të kryera në Shqipëri dhe mbikëqyrjes në shtetin tjetër pritës, për çdo auditim të kryer në atë shtet.

2. Në rastin e një auditimi ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara, BMP-ja nuk mund të vendosë kërkesa shtesë në lidhje me auditimin ligjor për sa i përket regjistrimit, rishikimit të dhënies së sigurisë për cilësinë, standardeve të auditimit, etikës profesionale dhe pavarësisë për një auditues ligjor ose shoqëri audituese që kryen një auditim ligjor të një filiali të themeluar në një shtet tjetër.

3. Në rastin e një njësie ekonomike, titujt e së cilës tregtohen në Shqipëri, BMP-ja nuk mund të vendosë asnjë kërkesë shtesë në lidhje me auditimin ligjor për sa i përket regjistrimit, rishikimit të dhënies së sigurisë për cilësinë, standardeve të auditimit, etikës profesionale dhe pavarësisë së një audituesi ligjor ose shoqërisë audituese që kryen auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore ose të konsoliduara të asaj njësie ekonomike.

4. Në rast se një auditues ligjor ose një shoqëri audituese, e regjistruar në regjistrin publik të audituesve në Shqipëri, është e regjistruar edhe në regjistrin publik në ndonjë shtet tjetër dhe ai auditues ligjor ose shoqëri audituese lëshon raport auditimi në lidhje me pasqyrat financiare vjetore ose pasqyrat financiare të konsoliduara, atëherë ky auditues ligjor ose shoqëri audituese do të jetë subjekt i sistemeve të mbikëqyrjes, sistemeve të dhënies së sigurisë për cilësinë dhe sistemeve të investigimit dhe masave disiplinore të shtetit tjetër.

5. Kërkesat e këtij neni janë të zbatueshme edhe, kur është e përshtatshme, për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë.

Neni 6

Sekreti profesional dhe bashkëpunimi rregullator ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera

1. BMP-ja dhe autoritetet kompetente të shteteve të tjera përgjegjëse për miratimin, regjistrimin, kontrollin e sigurimit të cilësisë, investigimin dhe disiplinën, si dhe Autoritetet Mbikëqyrëse Evropiane përkatëse, bashkëpunojnë ndërmjet tyre në përmbushje të detyrimeve mbikëqyrëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator vendas për auditimin, legjislacionin e shteteve të tjera dhe rregulloren përkatëse të BE. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet për të gjithë personat që janë të punësuar ose që kanë qenë të punësuar në BMP dhe nga autoritetet kompetente të cituara në pikën 1 të këtij neni. Informacioni i mbuluar nga sekreti profesional nuk mund t'i zbulohet asnjë personi ose autoriteti tjetër përveç rasteve kur kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator ose procedurat administrative të autoriteteve kompetente.

2. Pika 2 e këtij neni, nuk i pengon autoritetet kompetente të shkëmbejnë informacion konfidencial. Informacioni i shkëmbyer në këtë mënyrë mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional, të cilit i nënshtrohen personat e punësuar ose të punësuar më parë nga autoritetet kompetente. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet gjithashtu për çdo person tjetër të cilit autoritetet kompetente i kanë deleguar detyra në lidhje me qëllimet e përcaktuara në këtë rregullore.

3. Autoritetet kompetente japin, me kërkesë dhe pa vonesë, çdo informacion që kërkohet për qëllimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni. Kur është e nevojshme, autoritetet kompetente që marrin një kërkesë të tillë do të marrin masat e nevojshme për të mbledhur informacionin e kërkuar. Informacioni i dhënë në këtë mënyrë mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional të cilit i nënshtrohen personat e punësuar ose të punësuar më parë nga autoritetet kompetente që kanë marrë informacionin.

Nëse autoritetit kompetent i duhet më shumë kohë për të dhënë informacionin e kërkuar, ai do të njoftojë autoritetin kompetent kërkuues lidhur me arsyet përkatëse.

4. BMP-ja ka të drejtë të refuzojë kërkesat e autoriteteve kompetente të vendeve të huaja lidhur me dokumentacionin e auditimit në rastet kur:

a) dhënia e këtyre shkresave ose dokumenteve të punës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë;

b) në Republikën e Shqipërisë ka nisur procedim gjyqësor për të njëjtat vepra dhe ndaj të njëjtëve persona.

Pa cenuar detyrimet të cilave u nënshtrohen në procedurat gjyqësore, autoritetet kompetente ose Autoritetet Mbikëqyrëse Evropiane që marrin informacion në bazë të pikës 1 të këtij neni mund ta përdorin atë vetëm për ushtrimin e funksioneve të tyre brenda objektit të kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës për auditimin dhe në kuadrin e procedimeve administrative ose gjyqësore që lidhen veçanërisht me ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse.

5. BMP-ja, sipas kërkesës së tyre do t'i transmetojë, autoriteteve kompetente përgjegjëse për mbikëqyrjen e njësive ekonomike me interes publik, bankave qendrore, Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane, në cilësinë e tyre si autoritete monetare, dhe Bordit Evropian për Rrezikun Sistemik, informacione konfidenciale të synuara për kryerjen e detyrave të tyre. BMP-ja nuk pengohet t'i komunikojë autoriteteve kompetente informacionin që mund t'u nevojitet autoriteteve kompetente për të kryer detyrat e tyre sipas rregullores përkatëse të BE.

6. Kur BMP-ja konstaton se aktivitetet në kundërshtim me dispozitat e kuadrit ligjor dhe rregullator për auditimin po kryhen ose janë kryer në territorin e një shteti tjetër, ai do të njoftojë autoritetin kompetent të këtij shtetit për këtë konstatim në një mënyrë sa më specifike. Autoriteti kompetent i shtetit tjetër mund të informojë BMP-në për rezultatin dhe, për aq sa është e mundur, për zhvillime të rëndësishme të ndërmjetme.

7. Një autoritet kompetent i një shteti tjetër mund të kërkojë gjithashtu që të kryhet një investigim nga ana e BMP-së në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ai mund të kërkojë më tej që një pjesë e personelit të tij të lejohet të shoqërojë personelin e BMP-së gjatë investigimit.

Investigimi i nënshtrohet kuadrit rregullator në fuqi në Shqipëri.

BMP-ja mund të refuzojë të veprojë mbi një kërkesë për kryerjen e një investigimi siç parashikohet në paragrafin e parë të kësaj pike, ose mbi një kërkesë që personeli i tyre të shoqërohet nga personeli i një autoriteti kompetent të një shteti tjetër, siç parashikohet në paragrafin e dytë të kësaj pike, kur:

a) një investigim i tillë mund të cenojë sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë; ose

b) në Republikën e Shqipërisë ka nisur procedim gjyqësor për të njëjtat vepra dhe ndaj të njëjtëve persona.

8. Kërkesat e këtij neni janë të zbatueshme edhe, kur është e përshtatshme, për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë.

KREU III FORMAT DHE PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 7

Format e bashkëpunimit

1. Format e bashkëpunimit ndërinstytucional brenda dhe jashtë vendit bazohen në:

a) Kërkesa për informacion: Çdo kërkesë për informacion duhet të bazohet në qëllime të përcaktuara qartë dhe në përputhje me kreun II të kësaj rregulloreje, ku theksohet se autoritetet mbikëqyrëse duhet të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion të domosdoshëm për ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

b) Inspektive të përbashkëta: BMP-ja ka të drejtë të angazhohet në inspektive të përbashkëta me autoritetet homologe të BE dhe të shteteve të tjera për të garantuar standarde të përbashkëta të cilësisë dhe për të adresuar rreziqe të përbashkëta në auditim.

c) Shkëmbimi elektronik i informacionit: Realizohet përmes mjeteve të sigurta elektronike për të ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave.

ç) Mbështetje teknike dhe trajnime të përbashkëta: Në kuadër të bashkëpunimit reciprok BMP-ja mund të ndërmarrë veprime për ngritje kapacitetsh dhe ndarjen e praktikave më të mira nëpërmjet programeve të mbështetura nga donatorët.

d) Përdorimi i protokolleve të përbashkëta për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave: Gjatë bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit, të gjitha informacionet dhe të dhënat sensitive shkëmbehen vetëm përmes mjeteve të sigurta elektronike në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e të dhënave të personale.

dh) Zhvillimi i planeve të përbashkëta vjetore të mbikëqyrjes: BMP, në koordinim me autoritetet homologe, harton plane të përbashkëta pune për të siguruar një qasje të harmonizuar për mbikëqyrjen dhe investigimet.

Neni 8

Procedura për shkëmbimin e informacionit

1. Kërkesa për informacion duhet të përmbajë:

- a) Qëllimin dhe bazën ligjore;
- b) Natyrën dhe përshkrimin e informacionit të kërkuar;
- c) Afatin e përgjigjes së kërkuar, në përputhje me rëndësinë dhe urgjencën e kërkesës;
- ç) Masat për ruajtjen e konfidencialitetit dhe metodat teknike të përdorura për mbrojtjen e të dhënave.

2. Autoritetet kompetente marrin masat e nevojshme për të mbledhur informacionin dhe dhënien e tij sipas qëllimit të përmendur. Informacioni duhet të jetë i plotë, i saktë dhe i përditësuar.

3. Informacioni i dhënë nuk mund të përdoret për qëllime të tjera pa miratimin e autoriteteve kompetente dhe duhet të ruhet në përputhje me legjislacionin përkatës të palëve për ruajtjen e informacionit.

Neni 9

Kontrollet dhe investigimet përbashkëta

1. BMP-ja mund të marrë pjesë në kontrolle të sigurimit të cilësisë ose investigime të përbashkëta me autoritetet mbikëqyrëse homologe të një shteti tjetër në bazë të marrëveshjeve

të shkruara dhe kompetencave ligjore të përcaktuara për secilën palë. Kjo përfshin kontrolle për sigurimin e cilësisë ose investime të përbashkëta për audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese të regjistruar në regjistrin publik të shtetit përkatës.

2. Gjatë këtyre kontrolleve ose investimeve:

a) Përcaktohen objektivat, metodologjia dhe protokollet për menaxhimin e riskut dhe sigurisë së të dhënave të përpunuara;

b) Ndahen përgjegjësitë midis palëve për mbledhjen e informacionit, inspektimin në terren, përgatitjen e raporteve dhe komunikimin me subjektet në inspektim;

c) Përdoren mjete dhe formate të standardizuara për raportim, për të siguruar transparencë të rezultateve.

3. Rezultatet e këtyre kontrolleve ndahen në mënyrë të standardizuar dhe konfidenciale në përputhje me marrëveshjet e shkruara ndërinstitucionale për ruajtjen e të dhënave dhe kufizimin e përdorimit të tyre.

KREU IV

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL BRENDË VENDIT

Neni 10

Subjektet dhe mekanizmat e bashkëpunimit institucional

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike bashkëpunon me autoritetet dhe institucionet publike që ushtrojnë kompetenca mbikëqyrëse, rregullatore, apo hetimore të lidhura me auditimin ligjor dhe shërbimet e tjera të parashikuara në ligjin e auditimit. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes, transparencës, bashkë rendimit, koordinimit dhe efektivitetit të masave të ndërmarra për zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore. Këto bashkëpunime do të përfshijnë, por pa u kufizuar në to, palët si më poshtë:

a) Ministrinë përgjegjëse për financat – për çështje që lidhen me politikën fiskale dhe ligjore në fushën e kontabilitetit dhe auditimit;

b) Agjencinë e Inteligjencës Financiare - për çështje që lidhen me zbatimin e kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, kryerjen e inspektimeve tematike dhe ndarjen e informacionit të siguruar gjatë ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse përkatëse;

c) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare – për bashkërendimin e veprimtarisë mbikëqyrëse lidhur me cilësinë e auditimit të subjekteve që operojnë në tregun financiar dhe të sigurimeve;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – për shkëmbimin e të dhënave mbi përmbushjen tatimore dhe transparencën financiare të subjekteve të audituara;

d) Qendra Kombëtare e Biznesit – për sigurimin e informacionit të përditësuar rreth statusit ligjor të shoqërive tregtare dhe publikimit të informacioneve lidhur me raportimin financiar dhe auditimin ligjor;

dh) Banka e Shqipërisë – për shkëmbimin e informacionit, koordinimin e mekanizmave mbikëqyrës dhe ndarjen e ekspertizës në funksion të ruajtjes së stabilitetit dhe efikasitetit të sistemit financiar në Shqipëri;

e) Organet hetimore brenda vendit – për bashkëpunim në hetime dhe investime lidhur me vepra penale në fushën auditimit ligjor;

ë) Institucione të tjera sipas rastit.

2. Bashkëpunimi sipas pikës 1 të këtij neni do të realizohet në përputhje me kompetencat ligjore dhe rregullatore të secilës palë, si edhe përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis tyre.

3. Bashkëpunimi mund të përfshijë, ndër të tjera:

a) Shkëmbimin periodik të informacionit për subjektet e mbikëqyrura të secilës palë;

- b) Realizimi i takimeve të përbashkëta koordinuese për adresimin e çështjeve të parashikuara sipas kompetencave të parashikuara në ligjet përkatëse;
- c) Krijimin e grupeve të përbashkëta pune për zhvillimin e praktikave të përbashkëta dhe organizimin e trajnimeve.

KREU V BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 11 **Bashkëpunimi me autoritete homologe**

1. BMP-ja bashkëpunon dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet homologe të mbikëqyrjes së auditimit dhe autoritete të tjera në shtetet të tjera në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator vendas dhe kërkesat e kësaj rregulloreje.
2. Objektivat e këtij bashkëpunimi ndërkombëtar përfshijnë:
 - a) Krijimin dhe funksionimin e mekanizmave të bashkëpunimit bilateral dhe shumëpalësh;
 - b) Shkëmbimin e informacionit të strukturuar dhe të lidhur me audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - c) Marrjen ose dhënien e asistencës teknike për kontrolle dhe investigime të përbashkëta;
 - ç) Rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të përbashkëta dhe shkëmbimit të praktikave më të mira.
3. BMP-ja garanton që çdo shkëmbim ndërkombëtar të jetë në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave dhe të ruhet konfidencialiteti i informacionit të ndarë.
4. Marrëveshjet për bashkëpunim ndërkombëtar formalizohen nëpërmjet akteve të shkruara të cilat përcaktojnë qëllimin, kufizimet, standardet e konfidencialitetit dhe mënyrat e monitorimit të zbatimit të bashkëpunimit.

Neni 12 **Kompetencat e BMP-së në lidhje me bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të huaja**

1. Me kërkesë të autoriteteve kompetente të një vendi të huaj, BMP-ja mund të paraqesë dokumentacionin e auditimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, bazuar në parimin e reciprocitetit, nëse:
 - a) ky dokumentacion ka lidhje me auditimin e shoqërive që kanë emetuar letra me vlerë në një shtet të huaj ose që janë pjesë e një grupi që harton pasqyra financiare të detyrueshme të konsoliduara në një shtet të huaj;
 - b) autoritetet kompetente të shtetit të huaj në fjalë plotësojnë kërkesat e përputhshmërisë të përcaktuara nga kuadri ligjor vendas;
 - c) BMP-ja ka lidhur marrëveshje me autoritetet kompetente të vendit të huaj bazuar në parimin e reciprocitetit;
 - ç) transferimi i të dhënave personale në një vend të huaj bëhet në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.
2. Marrëveshja e parashikuar në shkronjën “c” të pikës (1) të këtij neni duhet të përfshijë:
 - a) detyrimin për të shpjeguar qëllimin e kërkesës në lidhje me dokumentacionin e auditimit;
 - b) detyrimin për të mbrojtur të dhënat konfidenciale për personat që janë ose kanë qenë të punësuar pranë autoriteteve kompetente të shtetit të huaj;

c) kërkesën që autoritetet kompetente të shtetit të huaj të përdorin dokumentacionin e auditimit vetëm për qëllime të kryerjes së mbikëqyrjes publike, sigurimit të cilësisë dhe investigimeve të krahasueshme me kompetencat e BMP-së.

3. BMP-ja ka të drejtë të refuzojë kërkesat e autoriteteve kompetente të vendeve të huaja lidhur me dokumentacionin e auditimit në rastet kur:

a) dhënia e këtyre shkresave ose dokumenteve të punës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë;

b) në Republikën e Shqipërisë ka nisur procedim gjyqësor për të njëjtat vepra dhe ndaj të njëjtëve persona.

KREU VI KOORDINIMI DHE ZBATIMI

Neni 13

Roli i Koordinatorit për Bashkëpunim

1. Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe për të siguruar vijimësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit, BMP-ja cakton një Koordinator për bashkëpunimin ndërinstitucional.

2. Koordinatori ka vetëm funksion administrativ dhe teknik, përfshirë:

a) Është pika e kontaktit midis BMP-së dhe palës bashkëpunuese;

b) Organizon dhe koordinon përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në kuadër të bashkëpunimit;

c) Monitoron procesin e shkëmbimit të informacionit dhe menaxhon dokumentimin e informacioneve të shkëmbyera;

ç) Ndjek zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, mbikëqyr afatet dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Neni 14

Ruajtja, arkivimi dhe shkatërrimi i informacionit

1. Informacioni i marrë ose i transmetuar nga BMP-ja, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit arkivohet dhe administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat, ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, aktet nënligjore të zbatimit të tyre dhe rregullat e brendshme të BMP-së për administrimin e dokumentacionit.

Neni 15

Dispozita kalimtare

1. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje koordinatori për bashkëpunim dhe struktura mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

2. Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga BMP-ja në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore janë të vlefshme.